Menjëherë pas djegies së karburanteve të depozitave ne Lagunën e Knallës, Ekolevizja, së bashku me shoqatën "EIRLA" të Lezhës, organizuan një vizitë në tërë zonën përreth vendit të ngjarjes. Ishin specialistët e njohur të shoqatës së Lezhës Jak Gjini dhe Ali Brahimi, ndërsa nga "Ekolevizja" Xhemal Mato dhe

e ndotura. Pastaj katër specialistët e mësipërm shëtitën lagunën e Knallës duke parë në vend përhapjen e naftës përgjatë gjithë lagunës dhe vlerësuan mundësinë e izolimit dhe pastrimit të sajë në terren. Të gjitha të dhënat e vizitimit me pikat e matjeve u hodhën në një hartë satelitore të zonës



Sazan Guri.

U organizua një takim me peshkatarët e lagunës të cilët dhanë një informacion mjaft të hollësishtë dhe të vlefshëm për lëvizjen e ujërave në lagunë dhe mënyrën e veprimit për të ndaluar ndotjen me naftë të të gjithë pjesës tjetër të lagunës. Njëkohësisht peshkatarët u treguan të gatshëm që të ndihmonin me forcat dhe mjetet e tyre në pastrimin e lagunës së Knallës e cila hë për hë ishte më

Të nesërmen, në dt. 24 dhjetor, grupi i specialistëve të "Ekolevizjes" pati një takim me zv. Ministrin e MPAU z. Taulant Bino si dhe drejtorët Roland Kristo, Zamir Dedei, Nehat Gollaku etj

Në këtë takim u diskutua për masat urgjente që duhet të marrëshin në lagunën e Knallës dhe bashkëpunimin e Ministrisë së Mjedisit me "Ekolevizjen" si dhe Ministrinë e Tjera në këtë drejtim.

Na ishte një herë, si shumë herë

Laguna e Shëngjinit nuk dihet se kur do të kthehet në normalitet, ndërkohë që një panoramë mortore ka pllakuar tashmë gjithë zonën e dëmtuar të Lagunës në Shëngjin. Kohë shumë e zymtë, kolë e pa kohë për t'u marrë me të Lagunën e postshkatërruar. Nga njëra anë situatë e rëndë politike, ndërsa nga ana tjetër prag festash, kanë bërë që të gjithë të heshtin pas zhurës së madhe që vetëm pak ditë më parë kumbonte si ndër më e mëdha katastrofë ekologjike në vënd. Asnjë masë, asnjë ndërkohë dhe aq një zë i mëpastajmë nuk dëgjohet. Teksa mediat trumbetonin me të madhe mrezikun e asaj që kishte ndodhur, në atë eufori fjalësh sërish na gënjeu mendja se do të mund të ndërgjegjësoheshin dhe diçka mund të ndodhte në të mirë. Por, si çdo fenomen tjetër që zhurmshëm me të drejtë pasqyrohet në arenën mediatike, pas pak ditësh humbet në tynajën e problemeve të politikës shqiptare. Me mijëra litra karburant janë dërdhur në Lagunë, duke shënuar një katastrofë ekologjike në afro 10 hektarë. Për të parë situatën nga afër ka qënë mes të tjerësh edhe ministri i Mjedisit, Luftër Xhveli, i cili në atë kohë e vlerësoi si shumë alarmante situatën dhe që kërkon impenjimin e të gjithëve. Në fakt kur ministri ynë bëri këto deklarime, të cilat janë kthyer si shprehje kortezje, nuk e veçoi veten, kështu që i bie që edhe ai të ishte pjesë e "të gjithëve".

Vërtetë dhe fatmirësisht në të njëjtën kohë laguna është e ndarë nga deti dhe

kjo bën që edhe dëmet të jenë më të vogla. Por kjo nuk do të thotë që pushteti qëndror, i cili menaxhon edhe lejet mjedisore, dhe që në një farë mënyre pikërisht për këtë mban një pjesë të madhe të fajit, të heshtë, sikundër ka heshtur për shumë të tilla katastrofa, dhe që në fund të fundit

klasat e gjitarëve, mërsa bloza është kancerogjene dhe mund t'u shkaktojë probleme banoreve të zonës. Mjafton të kesh një mburojë politike dhe ligjin mund ta interpretosh sipas gjendjes në të cilën ndodhesh, ti japësh formën që ti do, dhe ngjyrën, qoftë edhe të blözës që tashmë ka kapluar një pjesë

Duke qënë se nafta në ujë bën që organizmat e gjalla të mos marrin oksigjenin e duhur, nuk bëhet fotosinteza dhe nuk hyn drita, që do të thotë, ngordhje në sasi në të gjitha klasat e gjitarëve, ndërsa bloza është kancerogjene dhe mund t'u shkaktojë probleme banoreve të zonës. Mjafton të kesh një mburojë politike dhe ligjin mund ta interpretosh sipas gjendjes në të cilën ndodhesh, ti japësh formën që ti do, dhe ngjyrën, qoftë edhe të blözës që tashmë ka kapluar një pjesë të madhe të një prej lagunave më të bukura të vëndit.

janë komuniteti që mbart mbi supë rëndësën e tyre. Aktualisht janë të dëmtuar rreth 10 hektarë lagunë, që do duhet kohë për t'u pastruar. Ambientalistët vlerësojnë se dëmi për mjedisin është mjaft i madh dhe kemi të bëjmë me një katastrofë ekologjike të pariparueshme. Ambientalistët kanë thënë se lagunat e Shëngjinit janë të lidhura me detin dhe gjithë sasia e karburantit e dërdhur aty, mund të përhapet.

Duke qënë se nafta në ujë bën që organizmat e gjalla të mos marrin oksigjenin e duhur, nuk bëhet fotosinteza dhe nuk hyn drita, që do të thotë, ngordhje në sasi në të gjitha

të madhe të një prej lagunave më të bukura të vëndit. Nëse politika nuk është e interesuar të ndodhë ndryshe, gjithkush mund të bëjë ndryshe nga sa parashikon ligji.

Heshtja e kësaj madhe tregon edhe një herë papërgjegjshmërinë e atyre që ne na qeverisin në hallka të ndryshme të vëndit. Kjo vërteton se sa të ngushtë janë qeveritarët tanë shpirt, ku edhe në një herë të vetme nuk treguan se mund të bëjmë edhe diçka për komunitetin, të cilët shumë shpejt do ti ngërthejë epidemia nga substancat kancerogjene të çilnuara gjatë djegjes.



MJEDISI NË RADHË TË PARË

Nga prof. asc. Sazan GURI

Marra e veprimeve pozitive për t'u kujdesur për mjedisin, sot në tëqër se kurrë përmban mençurinë, që duhet të dallojë një vend. Gjithësi, pyjet e ahut po copëtohen akoma, peshkimi po kolapsohet, copa plastike po pushtojnë plazhet tanë, kanalizimet e ujërave të zeza vazhdojnë të derdhen në lumenjtë dhe detet tanë. Gjithësi, dita nuk shkon pa pasur një qështje, nga ato që i shkakton dëme serioze mjedisit, si derdhjet e naftës, shkatërimi i pyjeve, speciet në rrezik, dhe lista sa vjen e mëtej. Me frikë e themi, por ky degradim i mjedisit, hallka të të cilat sa vjen e po këputen mund të ndikojnë tek çdokush në jetën e vet.

Është e lehtë të fshihesh poshtë ombrellës së dikujt dhe të shpresosh për më të mirën. Gjithësi është e lehtë t'ia drejtosh gishtin dikujt tjetër dhe ta lësh turpin aty, por askush prej nesh nuk mund t'i injorojë problemet

në gjatë. Megjithëse, situata nuk është pa shpresa, vetëm se është urgjente.

Mojallja e pak përveç dhe riciklimi i disa lëndëve si letra është veçse fillimi. Të gjithë ne duhet të bëjmë

me aq takt sa ç'bëjnë qeniet e tjera fytyrore (jo njerëzore) mbi faqe të dhaut. Vëreni se sa me takt e miqësor ecin ato mbi tokë.

Ka shumë gjëra, që ne mund t'i bëjmë

- në varëse ne mund të jemi të sigurt për një të ardhme më të mirë. Nëse duan, që vendi ynë të ketë një mjedis të shëndetshëm, atëherë kemi një sfiidë të madhe para atyre që mendojnë, se shkatërimet e tokës, erozioni dëri në degradim të saj, rrëzimet, subsidanca, shpyllëzimet, shfrytëzimi barbar i inerteve dhe ujërave nëntokësore apo diçka tjetër shqetësuese për mjedisin të mund të konsiderohet si qështje dytësore. Shifrat janë tronditëse. Në të marrim erozionin. Disa njerëz thonë se erozioni i sotëm, jo vetëm në vendin tonë, është një proces natyral. Kështu është, por si rezultat i aktivitetit njerëzor, kjo po rritet dëri në disa qindra herë më shumë nga shka lla natyrore. Llogarisni, që në vend se të sedimentohet 1mm në dhjetë vjet erodhet 10mm në vit. Kjo nuk është tragjedi, vetëm për ata që duan natyrën. Kjo gjë duhet të shqetësojë çdokënd, që kujdeset për shëndetin e vet.

Nik është një rastisje, që qyteti i



ndryshime të vërteta dhe të mësojnë se si të silllemi me takt ndaj tokës. Gjithkush prej nesh, e ka në dorë, që çdo ditë, në çdo gjë që bëjmë të veprojë

në shtëpi, në zyrë, në shkollë dhe në komunitet. Ka ide, të cilat ne duhet t'ia paraqesim qeverisë. Nëse të gjithë ne bëjmë nga pak, dhe nëse ne fillojmë tani

Nëse nafta derdhet në det, dëmet e pallogaritshme

Katastrofa ekologjike që mbërtheu Shëngjinin

Ministria e Mjedisit nuk shqetësohet

Arti Lahi

Lezhë- Një qytet i nxirë nga tymi dhe dhurma e rëndë që kundërmon nga djegia e depozitave të naftës.

Kjo ishte pamja e Lezhës tashmë të zymtë, pas flakëve që sunduan në Shëngjin për 31 orë duke çliruar miliarda grimca helmuese. Rreth një mijë ton naftë të derdhura në tokë dhe det, rrezikojnë që ta shndërrojnë plazhin e Shëngjinit në zonë të pabanuar. Katastrofa ekologjike mund të jetë me përmasa disa vjeçare dhe do të ketë efekte në të gjithë bregdetin shqiptar. Shpërthimi i cisternave të naftës përveç rrezikut të menjëhershëm për banorët përreth do të ketë pasoja të mëvonshme. Sipas specialistëve të shëndetit publik helmët e çliruara mund të ndikojnë në sëmundje të ndryshme dhe dëri në defomime gjatë lindjes. Kjo ndodh pasi tymi dhe blloza kanë mbetje kancerogjene.

Pasojat

Pas ngjarjes së rëndë kanë reaguar menjëherë shoqatat mjedisore. Sipas ambientalistit Xhernal Mato nafta do të qëndrojë

për vite me radhë në lagunën e Shëngjinit dhe kjo mund të sjellë zhdukjen e shpendëve dhe kafshëve, ndërsa nëse derdhet në det, atëherë pasojat do të jenë edhe më të mëdha.

Mato theksoi se: " Situata në Shëngjin është katastrofike dhe përmban një rrezik potencial për gjithë bregdetin e vendit. Aktualisht sipërfaqja e ndotur në lagunë është mbi 10 hektarë". Mato kërkoi që banorët të informohen mbi rrezikun potencial që u kanoset, dhe që qeveria të kërkojë ndihmën e specialistëve të huaj për ndërhyrjen sa më të shpejtë në lagunë. Nga ana tjetër Ministria e Mjedisit i konsideron dëmet të vogla, pasi kjo lagunë ndodhet në një zonë të izoluar. Gjatë një prononcimi për mediat ministri Xhuveli u shpreh se nuk ka konstatime për shpendë apo gjallesa pa jetë. Gjithësi nunci një i dikasterit të mjedisit ka pranuar se derdha e mijëra litrave naftë përmban një kërcënim serioz për lagunën e Kërnallës.

Masat

Sipas Xhuvelit janë dërguar ekskavatorë për të nbyllur grykën

e komunikimit që lidh lagunën e Kërnallës me atë të Mexhanit". Ambientalisti Sazan Guri shprehet

shpërthenin në mënyrë që të bëhet transferimi i tyre në një vend tjetër.



se ministria tashmë nuk mund të marrë masa, pasi nafta është derdhur në lagunë e shkon detyrimisht në det, duke e bërë të pamundur nbylljen rrugëve të transportit.

Katastrofa nuk mbaron

Depozitat e naftës rrezikojnë jetën e banorëve të Shëngjinit. Do të duhej që depozitat të

Prej kohësh qytetarët e Shëngjinit kanë kërkuar transferimin e depozitave pasi rrezikonin jetën duke qenë se shtëpitë e tyre janë fare pranë. Me zë tashmë të irrituar pasi provuan rrethësinë përvëluese të flakëve përdori shtëpive banorët ankohen se depozitat janë si minë me saat. Në të njëjtën kohë kur

New York-ut, ka gjetur se është më lirë dhe më efektive të rregullosh një pyll, i cili prodhon ujë, sesa të ndërtohet një impiant të trajtimit të tyre.

Një nga pamullat e Lëvizjes së Gjelbër është "mendo globalisht dhe vepro logjikisht". Ministria e mjedisit, shoqatat ambientaliste dhe shoqëria civile mund të ndihmojnë në këtë lloj të menduari. Shteti dhe Qeveria nuk mund të arrijnë gjithçka vetëm.

Ambientalistët janë një prej shumë faktorëve, që mund të ndryshojnë mjedisin, ndërkohë që biznesi dhe tregtia kanë një ndikim direkt mbi mjedisin. Së bashku kanë përgjegjësi të ndryshojnë ndikimet negative drejt një sensi pozitiv. Institucione të tjera, si gupe interesi të shoqërisë civile dhe media, mund të jenë forcë tjetër lëvizëse e rëndësishme për edukimin e publikut, por jo kesi media, që mendojnë lokalisht dhe veprojnë ftohtësisht.

digjeshin depozitat e "Taci Oil", një pjesë e naftës silllej me bote pranë shtëpive të tyre. Ato janë të vendosura në mes të një lagjeje që ka qenë e banuar prej kohësh. Ankesat e tyre kanë mbërritur edhe në zyrën e Presidentit të Republikës dhe Kryeministrit me anë të letrave. Nëse situata nuk zgjidhet ata do të hidhen në grevë. Alarmi për rrezikun e madh që u kanoset Lezhjanëve nuk ka mbaruar pasi në qendër ndodhen më shumë se 10 depozita të naftës, që iu përkasin firmave "Alpet", "Taçi Oil" dhe "Ada Petrol".

Ngjarja

Flakët që kanë përpirë qindra ton naftë kanë filluar rreth orës 4.30 të mëngjesit me anë të një shpërthimi që mendohet se është telekomanduar. Eksplozivi është vene mes depozitave 2 dhe 3 pranë valvulave. Eihe pse flakët kanë shkatërruar shumë prej provave nga hetimet e deritanishme del se shpërthimi është komanduar nga njeocelular apo telekomandë në distance. Konkurrenca ka sjellë një katastrofë ekologjike si dhe lëndimin e 7 zjarfikësve.

Në Kune të Lezhës

205 mijë litra karburant të derdhur

Kune- Ngjarja e djegies së qindra tonëve karburant ka qenë e paralajmëruar. Burime nga uniformat blu thanë për gazetën "Ekolëvizja" se një javë para shpërthimit janë derdhur 205 mijë litra karburant nga këto depozita. Kjo pasi tubat e nëndheshëm të transportit të karburantit janë bllokuar. Sasia e madhe e karburantit është derdhur Kune të Lezhës duke shkakuar një tjetër situatë alarmante. Të gjitha këto fakte dalin në dritë vetëm pasi tragjedia trakti në dërt e zonës. Por asnjë reagim publik nuk ka patur nga ministria e mjedisit për

të përcaktuar dëmet ekologjike që u shkakton në atë periudhë nga derdha e 250 mijë litrave karburant në tokë. Madje akoma nuk ka ndonjë informacion nëse është kontrolluar apo jo dhe në çfarë mënyre kjo ndotje e rrezikshme ambienti. Në një kohë që bëhen projekte të shkurta për të afnuar turizmin, ku një prej tyre është Shëngjini dhe Kuna informacioni dhe reagimi mbi katastrofat ekologjike është mjaft i vakët Një tjetër problem i dukshëm është mungesa e mjeteve dhe e pajisjeve të posaçme për shërbimin zjarfikës për emergjencë si ajo e Shëngjinit.

Për të përballuar situatën u thirrën në ndihmë mjetet zjarfikëse nga Tirana, Shkoder, Durrësi dëri dhe Fieri e Vlora. Por autozjarfikëset shqiptare tradicionalisht janë të pajisura vetëm me rezervuarë uji dhe jo me lëndë të tjera që parandalojnë zjarret në cisternat e karburanteve apo të kimikateve. Vetëm rreth mesditës u sigurua shkuma që do të parandalonte përhapjen e këtij zjarri, e cila disponohet nga njëësia e aeroportit "Nënë Tereza" të Rinasit. Kjo lëndë u çua me vonesë në Shëngjin, në kohën kur zjarri kishte marrë përmasa të mëdha.

- Taci Oil – Kompania që zotëronte depozitat
- 5 – Numri i depozitave
- 5 milion e 880 mijë litra naftë
- 275 mijë litra benzinë
- 5 metra largësia e depozitave nga njëra-tjetra
- 7 min ka vonuar zjarfikësja e pare
- 7 zjarfikës te lënduar
- 7 vite kane depozitat ne këtë zone
- 9 automjete zjarfikës dhe
- 31 ore për të shuar flaket
- 3 milion euro demi financiar
- 1 pallogaritshëm demi ekologjik
- 205 tonë karburant u derdhën pak javë më parë



Argjinatura e Kirit në rikonstruksion

Anxhela Xhindoli

Banorët sërish në 'telashe'

Në stinët e lagështa gjithmonë del në pah edhe problemi i madh i pëmblytjeve, kryesisht në zonën Lezhë-Shkodër. Argjinatura e Lumit Kir, ka qenë për kohë të shkuara edhe tani problemi kryq, që asnjëherë deri në tani nuk ka mundur të rikuperohet sadopak, duke bërë të sistematikisht të zhumshme problemin, sa herë që kapriçot e motit veprojnë 'dhunshëm'. Emergjente është parë fillimi i punimeve për rikonstruksionin e argjiturës së lumit Kir, dhe në fund, puna ka filluar. Bëhet fjalë për një investim i cili do të zgjidhë pjesërisht problemin e pëmblytjes në qytetin e Shkodrës dhe rrethinat e tij. Në një kohë kur zbatimi i këtij projekti pritej që të shmangte vërshimin e ujërave të lumit, ka shkaktuar një tjetër problem. Rreth 30 familje të lagjes periferike "Bardhaj", të cilët

kanë banesat në afërsi të argjiturës janë izoluar totalisht nga pjesa tjetër e qytetit të

ardhur pasi firma gjatë punës për rikonstruksionin e argjiturës së lumit Kir, ka hedhur të gjitha

gjatë punimeve, banorët kanë kërkuar ndërhyrje të menjëhershme të pushtetit lokal për rehabilitimin e situatës. Grupujt mbeturinash dhe balta e madhe ka krijuar shumë vështirësi në lëvizjen e banorëve të këtij fshati, por kryesisht të fëmijëve të tyre që shkojnë në shkollë. Frika e shpërthimit të ujërave dhe pëmblytjes së asaj që kishin ndërtuar deri në tani, frika e një rifillimi të sërishëm nga e para, ka bërë që këta banorë ta mirëpresin këtë investim, madje ta përshëndetnin me të madhe këtë fenomen. Por askush nuk e mendoi më parë që mund të ndodhte ajo që ndodhi. Kjo, si shumë ndodhi të pafundme që kanë ndodhur me firmat ndërtuese të cilat punojnë jashtë çdo kriteri ligjor, mund të shërbejë edhe si një mërgjegjësim ndaj strukturave shtetërore, të cilat marrin rryshfete nën dorë, ndërsa

nga ana tjetër nuk shikojnë aspak kushtet në të cilat firma përkatëse do të zhvillojë punimet. Gjithsesi, pa dashur të anashkalojnë këtë fenomen, rrjedhojë e të cilit janë shumë probleme të tjera që në fund të fundit, kostoja e tyre rëndon mbi komunitetin, rikthehami sërish tek problemi kirian. Për vite të tëra, në kohë reshjesh, ujërat e lumit Kir vërshonin duke përmbytur dhjetëra hektarë tokë dhe duke rrezikuar dhe qytetin e Shkodrës. Sikundër edhe Lezha dhe qytete të tjera të Shqipërisë e kanë përjetuar dhe po e përjetojnë ende këtë fenomen. Askush nuk mendon të vërë në jetë atë qfarë pranon gjatë fustatës, ku prioritet është vetëm formulimi sa më bindës i 'gënjeshtrës' së radhës, me motivin për të vjelë një votë më shumë, që të sigurojë kamrigan e majne.



Shkodrës, pasi firma që kryen punimet ka bllokuar të vetmen rrugë lidhëse të kësaj lagjeje qytetin. Inicimimi i banorëve ka

materialet inerte në afërsi të banesave të tyre. Të izoluar dhe të gjendur mes një lluçe të pakalueshme, nga masivi i hedhur

Cilësia e ajrit në rrugën e përmirësimit

Shtohen dy pika për monitorimin e ajrit në kryeqytet

Metropoli shqiptar, që prej kohësh ruan statusin e kryeqytetit

në të ndotur në Europë, tashmë duket se edhe për të në sford po duket një fjollë ndryshimi. Pas shumë thirrjesh SOS nga kombëtarë e ndërkombëtarë për nivelin e lartë të ndotjes në vend,

Ministria e Mjedisit vendosur të shtojë pikat e monitorimit për cilësinë e ajrit, nga 5 pika që ishin më parë, në shtatë të tilla. Një prej tyre ndodhet pranë Institutit të Mjedisit, ndërsa tjetra pranë Institutit Hidro-Meteorologjik. Duke u mbështetur në studimet mbi nivelin e ndotjes së ajrit në kryeqytet dhe faktorët që ndikojnë në përkëqësimin e situatës, të realizuara nga organizata të ndryshme mjedisore, një ndër faktorët kryesorë ndotës të ajrit rezultoi fluksi i ndotjeve, të cilat nuk respektojnë asnjë kriter. E rja në rritje e ndotjeve ka qenë dhe vazhdon të jetë në përpjesëtim të drejtë me nivelin e ndotjes së ajrit. Nga kjo ndotje e tejskajshme vjen edhe rritja në numër e të prekurve me sëmundje të ndryshme të

mushkërive etj. Nga pluhuri vihet re një rritje e numrit të vdekjeve të parakohshme nga kanceri në mushkri dhe një rritje e ngamimeve kronike në sy, gjithashtu vihet re dhe një reagim mendor i ulët.

Shtatë pika monitorimi për cilësinë e ajrit

Në Tiranë kanë qenë vetëm pesë pika ku bëhej monitorimi i cilësisë së ajrit, ndërkohë tani i janë shtuar dhe dy pika të tjera, të cilat janë përkatësisht të Instituti i Mjedisit dhe të Instituti Hidro-Meteorologjik.

Ndërkohë specialistët hedhin një dritë jeshile mbi rritjen e cilësisë së ajrit që thithim çdo ditë. Ndërkohë që shpjegojnë se janë

ulur elementët kimik të dëmshme, si Squfuri dhe Plumbi deri në standardet e kërkuara, ndërsa grimcat e ngurta përbëjnë një problem të madh, pasi ato vazhdojnë të jenë ende mbi normën e lejuar. Pra, në këtë periudhë, në Tiranë numërohet shtatë pika monitorimi të cilësisë së ajrit, dhe kjo ka ardhur për shkak se nga studimi i fundit i kryer nga Instituti të Shëndetit Publik, Tirana rezultoi një nga qytetet më të ndotura në vendin tonë. Zonat më të ndotura në kryeqytet janë qendra e Tiranës, Zl Dhjetori, zona pranë Kombinatit dhe pjesa e Unazës. Duke u bazuar në këto të dhëna rezultoi se zonat më të populluara, me në shumë lëvizje kanë edhe përqindjen më të madhe të ndotjes së ajrit.



"PARKU BALLKANIK I PAQES" promotor i zhvillimit mjedisor

Larg barrierave kufitare, për një mjedis rajonal të gjelbër

Nisma të ndryshme janë ndërmarrë në mbrojtje të mjedisit, për ndërhyrjen emergjente, sa nuk është vonë rikuperimi i mundshëm. "Parku Ballkanik i Paqes", një projekt që synon mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e turizmit dimëror dhe atij veror, duke përfshirë tre vende, përkatësisht Shqipërinë, Kosovën dhe Malin e Zi, është një ndër promotorët kryesorë në mjedis të këto vende. Shkoda ka pritur këto ditë përfaqësues të shoqatave ndërkombëtare mjedisore dhe turistike, të cilët kanë diskutuar mbi ecurinë e këtij projekti "Parku Ballkanik i Paqes" që ka nisur tre vjet më parë. Në vazhdim e takimeve të ndryshme, të mbajtura në vendet respektive pjesëmarrëse në projektin "Parku Ballkanik i Paqes", veçojnë të

fundit, organizuar në muajin nëntor në Kosovë, ku edhe u firmos "Letra e Mirë", nënshkruet e së cilës ishin kryetarët e bashkive dhe të komunave të Rajonit, si ai i Bajram Currit, Deçanit, Rrëshajës dhe Plavës. Ndërsa në këtë takim, kjo letër u nënshkrua dhe nga autoritetet vendore të Shkodrës, të përfaqësuar nga kryetari i parkut të Shkodrës, Lorenc Luka, duke i hapur rrugë përfundimit të këtij aktiviteti, që pritet të marrë përmasa ndërkombëtare. Takimi u zhvillua në sallën e senatit të Universitetit "Luigj Gurakuqi" në Shkodër, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të shoqatave të ndryshme, pjesë e projektit "Parku Ballkanik i Paqes, si nga Shqipëria, Mali i Zi, Serbia, Maqedonia, Kosova, përfaqësues të

UNESCO-s, pushtetit lokal në Shkodër, dhe ambasadës britanike, mbështetëseja kryesore e këtij projekti. Ky takim aktiv përsa i përket edhe diskutimeve mbi çështje të ndryshme që preokupojnë komunitetin. Në këtë kuadër, Nënqim Çirçka, drejtues i shoqatës "New Community", me qendër në Shkodër, njëkohësisht mbështetëse e projektit që nga vitit 2003, është shprehur mbi qëllimin e këtij projekti, që padyshim konsiston në organizimin e "Parkut Ballkanik të Paqes", pa ndarje kufitare. Kështu që mes tre kufijve, Shqipëri, Kosovë dhe Mali i Zi të organizohet një Park Ballkanik Paq, i cili merret të jetë pa kufij dhe do të kontribuojë në mbrojtjen e mjedisit, në zhvillimin e turizmit dimëror dhe atij veror dhe

padiskutim do të jetë një simbol paqesje për rajonin dhe Ballkanin, duke ndikuar dhe në bashkëpunimin rajonal. Në këtë takim ishin të pranishëm edhe protagonistët të cilët jetojnë jashtë kufijve gjeografikë të tre shteteve pjesëmarrëse në projektin "Parku Ballkanik i Paqes", ku mund të përmendim Naim Hasani, shqiptar me banim në Londër. I kontuar në cilësinë e anëtarit të bordit ekzekutiv i "Parkut Ballkanik të Paqes", me qendër në Londër Hasani vlerësoi qytetin e Shkodrës, si qyteti më i përshatshëm për organizimin e aktiviteteve të vazhdueshme, sidomos ballkanike, kjo duke qenë se ky qytet është edhe një qendër e rëndësishme e vendit. Duke vizuar, Hasani bëri të ditur se projekti në fjalë është krijimi i një

parku paqesje mes vendeve të Ballkanit, ku të gjithë të bashkëpunojnë për zhvillimin e turizmit në këto zona. Synimi më i projektit cilësohet edhe kthimi i 'parkut' në simbol të paqes dhe të kalimit të lirë të qytetarëve nga të gjitha anët e Shqipërisë, Malit të Zi dhe Kosovës, në një zonë të pandarë, pa kufij. Të tjerë të pranishëm në këtë aktivitet që për nga rëndësia kapërcen çdo barrierë kufitare u shprehën lidhur me zonën që parashikohet të përfshijë ky park. Parku Ballkanik i Paqes fillon nga zonat e Vemoshit, Thethit, Valbonës në Tropojë duke vazhduar në Kosovë, Deçan, Bjeshkët e Rugovës, Bjeshkët e Rrozhajës, Plavë, Guci, dhe lichen përsëri me zonën e Vemoshit, pra e qajtur ndryshe "Bjeshkët e Namuna.



Shkurt nga bota

POPULLATA E ARINJVE POLARË NË ZHUKJE

Numri i popullatës së arinjve polar ka ardhur ndjeshëm në rënie. Ka vetëm 19 popullata arinjsh polar në të gjithë botën, kështu kjo rënie përfshin më shumë se ¼ e popullatës së këtyre specieve. Rënia e popullatës së arinjve polar tregon që i gjithë Arktiku është nën një tension të madh si rezultat i ndryshimit të klimës.

Sipas studuesve-Ne duhet të ndalojmë dhe largojmë ngrahjen globale pasi ka shkakuar zhdukjen e këtyre popullatave. Ky lajm nuk është alarmant vetëm për arinjtë polar por dhe për specie të tjera të Arktikut, si dhe për njerëzit që banojnë në këtë zonë. Duke u bazuar nga raporti i publikuar nga një grup specialistësh të



IUCN (World Conservation Union) për arinjtë polar dy nga nënpopullatat më të mirë në botë si ajo në Kanada dhe në pjesën jugore të detit Beaufort kanë pasur një rënie prej 22 % dhe 17% respektivisht gjatë dy dekadave të kaluara.

Popullatat e tjera në zhukje janë ato në Baffin Bay dhe Kane Basin të shpërndara ndërmjet Groenlandës dhe Kanadasë "Ndryshimi i klimës është kërcënimi kryesor për arinjtë polar, pra stabilizimi i klimës është mënyra e vetme për mirënjohjen e këtyre specieve.

Burimi - WWF

MACJA, KAFSHA MË E HERSHME E SHTËPISË
Shkenoëtarët thonë se një varr në ishullin mesdhetar të Qipros ka provuar se mes maceve dhe njeriut ekziston një lidhje e hershme, gati 9 500 vjeçare.

Duke shkruar në revistën Shkenca, studiuesit

Shkurt nga bota

francezë thanë se skeleti i një maceje të egër ishte gjetur i varrosur pranë eshtrave të një njeriu të epokës së reolitit.



Kjo sipas tyre sugjeronte se macja ishte një kafshë shtëpiake, moshita e vrazë pas vdekjes të të zotit të saj.

Shkenoëtarët besojnë se macet e egra u afruan me njerëzit pasi ato luftonin minjtë që hanin drithërat. Deri tani beshej se egjiptianët e lashtë ishin të parët që zbutën si kafshë shtëpiake macet, kjo rreth 4 mijë vjet më parë.

BASHKIMI EUROPIAN KALON LIGJIN E RI PËR KIMIKATET

Sipas legjislacionit REACH, shoqëritë në B.E kanë për të siguruar të dhëna për kimikatet e prodhuara rreth 10 ton për vit dhe ka një mekanizëm për zëvendësimin e vazhdueshëm dhe bio-akumulues të kimikateve në qoftë se alternativa më të sigurtë ekzistojnë.

Bruksel, Belgjikë - Pas shumë vitesh debat, ligjvënësit evropian miratuan ligjin e ri për kimikatet që do të detyrojnë prodhuesit dhe importuesit e kimikateve të sigurojnë që substancat që shfaqen në tregun evropian të jenë të sigurtë për konsumatorët duke u mbështetur tek WWF legjislacioni i njohur me emrin REACH-arritje (regjistrimi evoluimi, dhe autorizimi i kimikateve e vendos europën në një hap modest përpara afrimit të rregullores së kimikateve. Shoqëritë do të kenë tani siguri për prodhimin rreth 10 ton kimikate në vit dhe

Shkurt nga bota

ka një mekanizëm për zëvendësimin e vazhdueshëm dhe bio-akumulues të kimikateve në qoftë se alternativa më të sigurtë ekzistojnë. Po ashtu në këtë rregullore përfshihet dhe marrja parasysh e informimit të publikut rreth prezencës së kimikateve të rrezikshme në produkte.

"Bashkimi evropian është tani duke insistuar që kimikatet formohen gradualisht në organizmat e gjalla dhe ato që mbeten në mjedis për një kohë të gjatë do të zëvendësohen kudo që të jenë alternativat më të sigurtë të mundshme. Sa herë që shtegjet kryesore do të lejojnë akoma shumë kimikate që mund të shkaktojnë probleme serioze me shëndetin duke përfshirë kancerin, difektet në lindje dhe sëmundjet e riprodhimit..Për veç legjislacionit shumë kimikate me rrezikshmëri të madhe do të lejohen në treg në qoftë se prodhuesit deklarojnë se ata mund ti kontrollojnë ato. Por deklarimi që kimikate të tilla mund të kontrollohen është refuzuar nga një numër shkenoëtarësh, studiuesish duke përfshirë analizat e gjakut të marra nga WWF në më shumë se 350 njerëz në të cilat ka rezultuar një numër të madh kimikatesh toksike në çdo mostër gjaku.



"Pa mbështetjen e nevojshme kimikatet e rrezikshme do të vazhdojnë të infektjnë jetën e egër, shtëpitë tona dhe trupat tonë. Legjislacioni -REACH pritet të hyj në fuqi në mesin e vitit 2007.

Burimi- WWF

Kuriozitete nga mjedisi

- Bretkosa në e vogël në botë është aq e vogël sa që mund të futet në një gishtëz.
- Thithëlqja është një kontrollues natyral i insekteve dëmtues, ajo mund të hajë më shumë se 100 insekte në ditë.
- Amazona ka varietetin më të madh të thithëlqave në të mēdha në botë. Cuvucu është rreth 30 cm dhe peshon më shumë se 1 kg.
- Krokodilët më të gjatë mund të arrijnë deri në 8 metër.
- Fjala "dinozaur" e ka origjinën nga "deinos" greke, që do të thotë i tmerrshëm ose i rëndë, e kombinuar me "sauro" që do të thotë hardhuçë. Ky emër, "hardhuçë e tmerrshme" është për shkak të faktit se dinozaurët shiheshin fillimisht si krijesa gjigante dhe të llahtarshme.
- Një vezë struci mund të peshojë deri në 1.5 kg.
- Një kangur mund të kërcëjë deri në 3.6 m lartësi, I shtyrë nga këmbët e tij të pasme.
- Pavarësisht nga pëmasa e saj e madhe, qafa e gjirrafës ka vetëm 7 kocka.
- Tqazi është një gur i quar i mallë, në i përdoruri në bizuteri. Ai mund të jetë pa ngjyrë ose blu, i bardhë, gri, jeshil, i verdhë, kafe, portokalli, vjollcë ose ciklamirë. Sidoqoftë, nëse i ekspozohet dritës dhe ngratësisë së diellit, ngjyra e tij mund të pësojë ndryshime.
- Devetë janë përshatur për të jetuar në klimë të thatë. Kur gjejnë ujë ato mund të pinë 70-100 litra në vetëm 10 minuta. Ato mund ta mbajnë këtë për ditë të tëra dhe mund të udhëtojnë në shumë se 250 km.
- Mercinangat ndërtojnë rrjeta të tipeve të ndryshme për të kapur prehtë. Rrjetat përbëhen nga një proteinë e lëngshme në formë fi-jesh. Ato mund t'i marrin këto materiale ushqyese duke ngrënë.
- Nafta e ka origjinën nga organizmat detare të thellësive të oqeaneve, të cilat kanë qenë të mbuluara nga llumi dhe të kushtëzuara për të vepruar nga dekompozimi i mikroorganizmave.



Adresa e redaksisë: Ish- klinika qeveritare, shkalla 3, kati IV, Tiranë
Tel.: 04 234 851, Cel.: 068 21 82081 e-mail: ekolevizja@yahoo.com

TIRAZHI: 600 KOPJE

STAFI
EDITORI - Xhemal MATO
Kryeredaktore - Argetina TANUSHI
GAZETARË: - Rovena TASHI
- Indrit KODRA
- Anxhela XHINDOLI